



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:227061

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05659907

P.nr.1100/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti Përgjithshëm, gjyqtarja vetëm gjykuese Vjollca Buzhala, me sekretaren juridike Drita Gërmizaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. P., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1833-7/2023 të datës 25.10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarit B. P., me datë 30.04.2024 mori dhe shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. P., nga i ati, e ëmae lindur, i lindur me, i lindur në Dragash, me vendbanim në Prizren, ku edhe tani jeton, i martuar, me profesion menaxher , i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovë, me nr. personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 01.10.2023, rreth orës 13:25 minuta, në rrugëm “Hoxhë Tahsini” në Prizren saktësisht tel stadiumi “Përparim Thaqi”. I pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit H.Xh., në atë mënyrë që, si rrjedhojë e një mosmarrëveshjeje të atëçastshme, derisa kishin qenë duke shikuar ndeshjen e futbollit në lokacionin e lartëpërmendur, papritmas i pandehuri afrohet tel bina dhe fillon të fyen e të shanë, i dëmtuari i thotë që të mos shajë pasi që aty ka prezent edhe fëmijë, në atë moment i pandehuri i revoltuar e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grusht në fytyrë, me ç’rast i njëjti ka pësuar lëndime të lehta trupore si: ndrydhje të indeve të buta në regjionin nën syrin e majtë, gërvishtje në mjekër. Të shkaktuara nga veprimi i mjetit të fortë, të përshkuara si në akt ekspertimin e ekspertit mjekoligjor të Dr. F.B., datë 10.10.2023

Me këto veprime kryen veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69,70,71,72,185 par.1, nën par.1.4 të KPRK-së dhe 242, nenit 364 të KPPRK-së, të i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej pesëqind (300) euro, të cilën duhet ta paguaj të cilën gjobë do ta paguaj në dy këste dhe atë prej dt.01 deri me dt.10 të secilit muaj në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të llogaritet me 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, dhe atë 20 euro ne emër të ekspertizës mjeko-ligjore, ne emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzet (20) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet euro (20) euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i krimeve të rënda, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1833-7/2023 të datës 25.10.2023, kundër të akuzuarit B. P., me vendbanim n; Prizren, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Pas pranimit të shkresave të lëndës, gjyqtarja e vetme gjykuese me datën 30.04.2024 ka caktuar shqyrtimin fillestar, ku i akuzuari pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat i takojnë sipas ligjit, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, e ka pranuar fajësinë që i ngarkohet me aktakuzë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas dispozitivit të aktakuzës dhe shton se kërkon nga gjykata që t'i shqiptoj një dënim më të butë, ndihem tejet i penduar për veprimin e bërë, kërkoj falje në prezencën e juaj, jam munduar që të rregullohem me të dëmtuarin duke i dërguar njerëz mirëpo pa rezultat, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe garantoj që në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla inkriminuese apo të ngjashme.

Prokurori i Shtetit në fjalën e vet ka theksuar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga se konsideroj se e njëjta është bërë në bazë vullnetare, ku i akuzuari paraprakisht është udhëzuar nga gjyqtari gjykues për pasojat e pranimit të fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e te akuzuarit dhe provave materiale ne shkresat e lendes ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me datë 01.10.2023, rreth orës 13:25 minuta, në rrugën Hoxhë Tahsini në Prizren i pandehuri B. P., me dashje i shkakton lëndim trupor të dëmtuarit H.Xh., në atë mënyrë qe, si rrjedhojë e një mosmarrëveshjeje atëçastshme, derisa kishin qenë duke shikuar ndeshjen e futbollit në lokacionin e lartëpërmendur, i pandehuri afrohet tek bina dhe fillon të fyen e të shanë, i dëmtuari i thot që të mos shajë pasi që aty ka prezent edhe fëmijë, i pandehuri e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grusht në fytyrë, me ç'rast I shkakton lëndime trupore si ndrydhje të indeve të buta në regjionin nën syrin

e majtë, gërvishje në mjekër, të shkaktuara nga veprimi i mjetit të forte të përshkuara si në akt ekspertimin e ekspetit mjeko-ligjor të punuar nga Dr.F.B., me datë 10.10.2023.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Në bazë të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, formohen elementet e veprës penale të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, për të cilën është edhe penalisht përgjegjës, andaj është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligji.

Duke u bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, pasi që rrethana renduese nuk pati, si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh sidomos faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë, është penduar thellë për veprën e kryer, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do ti përsëris veprimet e tilla inkriminuese apo të ngjashme.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi ndaj të akuzuarit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në “parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimin për respektimin e ligjit”.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të Ligjit nr.05/L-036

Si u cek më lartë, u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:227061, 07.05.2024

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.